



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 16.3.2023
Nr. Prot 1731

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se është përgatitur projektvendimi: "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në qendrën e votimit, si dhe të procedurave të rekrutimit".

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "ë" dhe 2, shkronja "c", nenit 23, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, miratimi i këtij projektvendimi është kompetencë e Komisionit Rregullator.

Për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe relacionit shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

